



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK  
GJIROKASTËR

Nr. 71 Prot

Gjirokastër, më 13/2/2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, “Për krijimin për procedure paralele mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Ofruesi publik i AFP-së Drejtoria Rajonale e Ofritit të Formimit Profesional Publik, Gjirokastër ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin Instruktor me kohë të pjesshme të kursit Kopshtari .


- Pozicioni

a) Instruktor për kursin Kopshtari . -- 1 person ( Gjirokastër)

1) **Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të forms së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

- 
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
  - f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit ;

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

## 2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certificate ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 23.02.2023

**DREJTOR**

**Sulo MUÇOBEGA**

